



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e Gjuhës A

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri : Viti I , Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRSHKRIMI I LËNDËS

Studenti duhet të njohë shumë mirë gjuhën shqipe. Kjo është një lëndë me detyrim dhe me karakter hyrës dhe të përgjithshëm, që do t'u ofrohet studentëve të italishtes, viti i partë, Bachelor, (FGJH, UT). Lënda i formon studentët në fushën e morfologjisë shqipe.

Në këtë lëndë studentët do të plotësojnë njohuritë e tyre rreth objektit të morfologjisë, pjesëve të ligjëratës, kuptimeve dhe formave gramatikore, si dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore. Duke përvetësuar këto njohuri, studenti do ta ketë më të lehtë të përvetësojë edhe gjuhën e huaj, për të cilën studion. Leksionet do të jenë të përgatitura me format « Powerpoint », çka do ta bëjë më gjithëpërfshirëse lëndën, duke qenë vetë studentët që të plotësojnë apo të japin mendimet e tyre rreth njohurive që kanë për këtë lëndë. Po ashtu edhe ushtrimet praktike do të përgatiten me të njëjtin format, në bazë të leksionit që shpjegohet, dhe aktivizimi i studentëve do të plotësojë edhe ato mangësi që mund të kenë mbetur nga arsimi parauniversitar.